



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integrimit Evropian -
Ministarstvo evropskih integracija - Ministry of European Integration

Raport mbi zbatimin e
Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-
Asociimit (PKZMSA) gjatë periudhës janar - mars 2019

Maj 2019
Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	4
0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKZMSA-SË GJATË PERIUdhËS JANAR – MARS 2019	5
0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike	6
0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike	7
0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	7
0.4. Gjendja sipas institucioneve	9
1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE	12
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit	12
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	12
1.1.2. Administrata publike	12
1.1.3. Avokati i Popullit	12
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	12
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare	13
2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE	14
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut	14
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	14
3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË	15
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	15
3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave	15
3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve	15
3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	15
3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit	15
3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik	16
3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive	16
3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale	16
3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës	17
3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare	17
3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat	18
3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural	18
3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	19
3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria	19
3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit	19
3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia	19
3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet	19
3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare	19
3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat	20
3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi	20
3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	20
3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane	20
3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	20
3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	21
3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria	21
3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore	22
3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimit dhe kultura	22
3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi	22
3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	22

3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor	22
3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë	22
3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes	23
3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar	23
3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe ato buxhetore	23
<i>Shtojca 1. Pasqyrë e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Gjendja e zbatimit të të gjitha masave të planifikuara për këtë tremujor</i>	
	24
<i>Shtojca 2: Pasqyrë e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Lista e masave të zbatuara para afateve të parapara</i>	
	30

HYRJE

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2019 – 2023 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 19 mars 2019. Ai është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore, të cilat obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra nën përgjegjësinë e tyre, siç janë planifikuar, dhe të monitorojnë zbatimin e tyre. Qeveria, si mekanizmi qendror nacional përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, mbikëqyr zbatimin e PKZMSA-së përmes institucionit të mandatuar ligjërish për koordinimin e procesit të integritimit në BE – Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE).

MIE monitoron zbatimin e PKZMSA-së, respektivisht të masave afatshkurtra, në baza tremujore, përmes raporteve të rregullta. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe përmirësuar zbatimin e PKZMSA-së, dhe për qëllim të llogaridhënies e transparencës brenda institucioneve dhe ndaj palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë. Gjetjet, mes tjerash, diskutohen nga kabineti i Qeverisë dhe nga organet e stabilizim-asociimit BE – Kosovë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Ky është raporti i parë për vitin 2019, dhe mbulon periudhën 1 janar – 31 mars. Të dhënat janë raportuar nga secili institucion përgjegjës përmes *Platformës Online për Monitorim dhe Raportim për Integritim Evropian*, sipas matricës së masave afatshkurtra dhe bazuar në udhëzuesin për këtë qëllim. Në kapitujt ku të dhënat janë raportuar me vonesë ose në mënyrë joadekuate, ato nuk janë përfshirë në raport, dhe masat përkatëse janë vlerësuar si të pazbatuara, përkatësisht që përballen me vonesa serioze. Zbatimi i programit është vlerësuar sipas statusit të ecurisë (paraqitur në diagrame) për masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda periudhës raportuese (janar – mars), dhe atë si në vijim:

- Masat e zbatuara (ato të cilat janë zbatuar plotësisht) – me **të kaltër**; dhe
- Masat e pazbatuara (ato të cilat nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht, pra që përballen me vonesa serioze) – me **të kuqe**.

Ky raport, që përmban katër kapituj, ndahet në dy pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi dhe ajo mbi secilin bllok. Kapitulli 0 jep një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin e Programit gjatë periudhës raportuese. Ky kapitull është i ndarë më tej në pesë pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi, pjesa mbi kriteret politike, pjesa mbi kriteret ekonomike, pjesa mbi standardet evropiane, dhe pjesa sipas institucioneve. Secila pjesë e këtij kapitulli përmban diagramin dhe pjesën narrative (shpjegimin e gjetjeve). Teksti narrativ për secilin bllok përmbillet me një vlerësim cilësor të gjendjes, ku përmbledhen sfidat kryesore në bllokun përkatës, me theks të veçantë në masat që nuk kanë arritur të përmbushen brenda afatit gjatë periudhës raportuese dhe ato që kërkojnë vëmendje gjatë tremujorit vijues.

Kapitujt 1, 2 dhe 3 janë uniformë – secili përmban nga dy pjesë për secilin kapitull të Programit: diagramin dhe pjesën narrative. Diagramet paraqesin gjetjet mbi nivelin e përgjithshëm të zbatimit të kapitullit përkatës të Programit *gjatë periudhës raportuese* – në raport me masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda këtij tremujori. Pjesa narrative e secilit diagram jep një përmbledhje sasiore të këtyre gjetjeve, pra numrin dhe përqindjen e masave të zbatuara nga masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda kësaj periudhe. Pjesa narrative gjithashtu jep një vlerësim të shkurtër cilësor të gjendjes së përgjithshme në fushën përkatëse.


Raporti gjithashtu përmban dy shtojca. Shtojca 1 paraqet gjendjen e zbatimit të të gjitha masave të Programit gjatë tremujorit të parë. Shtojca 2 paraqet listën e masave të zbatuara gjatë këtij tremujori para afateve të parapara.

Të dhënat tregojnë se gjatë tremujorit të parë 2019 **Programi është zbatuar në nivel prej 30%: 12 nga 40 masat** e planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar plotësisht, ndërsa 28 prej tyre (70%) akoma nuk janë zbatuar plotësisht (shihni diagramin 0.2., fq. 6). Për më tepër, **12 masa janë zbatuar para afateve** të parapara.

0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKZMSA-SË GJATË PERIUdhËS JANAR – MARS 2019

Programi përmban **401 masa**: 160 (39.9%) masa legjislativë dhe 241 (60.1%) masa zbatuesë; prej tyre, 40 masa (10%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë: 31 (77.5%) masa legjislativë dhe 9 (22.5%) masa zbatuesë.

Diagrami 0.1. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Programi në tërësi




Sa i përket shkallës së zbatimit të **Programit gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 30% e masave, 12 masa, janë zbatuar plotësisht;
- 70% e masave, 28 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Nga gjithsej 401 masa, Programi përmban **160 masa legjislativë**; prej tyre, 31 masa (19.38%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 0.2. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: masat legjislativë




Sa i përket shkallës së zbatimit të **masave legjislativë gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25.81% e masave, 8 masa, janë zbatuar plotësisht;
- 74.19% e masave, 23 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Nga gjithsej 401 masa, Programi përmban **241 masa zbatuese**; prej tyre, 9 masa (3.73%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 0.3. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: masat zbatuese




Sa i përket shkallës së zbatimit të **masave zbatuese gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 44.44% e masave, 4 masa, janë zbatuar plotësisht;
- 55.56% e masave, 5 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike

Ky bllok përmban **35 masa**: 13 (37%) masa legislative dhe 22 (63%) masa zbatuese; prej tyre, 6 masa janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë: 4 (66.66%) masa legislative dhe 2 (33.34%) masa zbatuese.

Diagrami 0.1.1. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Kriteret politike



Sa i përket shkallës së zbatimit të **këtij blloku gjatë tremujorit të parë**, a tregojnë si në vijim:

- 33.34% e masave, 1 masë, janë zbatuar plotësisht;
- 66.66% e masave, 5 masa, nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese për secilin kapitull të këtij blloku, masat kyçe të planifikuara për periudhën raportuese të cilat **nuk kanë arritur të zbatohen brenda afatit të paraparë** janë:

- Miratimi i dy projektligjeve në fushën e administratës publike: për racionalizim të agjencive dhe institucioneve të pavarura; dhe atij për kontestet administrative;
- Miratimi i plotësim-ndryshimit të UA nr. 2012/01 për monitorimin e punës së organeve komunale përmes teleprezencës;
- Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Dizajnimi i portalit *e-Kosova*.

Në anën tjetër, masat kyçe të cilat përballen me *sfida dhe vonesa të mundshme*, dhe si të tilla *kërkojnë vëmendje* në kuadër të këtij blloku janë si në vijim:

- Miratimi i dy projektligjeve në fushën e administratës publike: për racionalizim të agjencive dhe institucioneve të pavarura; dhe atij për kontestet administrative.


0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike

Ky bllok përmban **5 masa**: 1 (20%) masë legislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij blloku gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane - përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky bllok përmban **361 masa**: 144 (39.88%) masa legislative dhe 217 (60.11%) masa zbatuese; prej tyre, 34 masa janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë: 27 masa legislative dhe 7 (20.59%) masa zbatuese.

Diagrami 0.3.1. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Standardet evropiane



Sa i përket shkallës së zbatimit të *këtij blloku gjatë tremujorit të parë*, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 32.35% e masave, 11 masa, janë zbatuar plotësisht;
- 67.65% e masave, 23 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese për secilin kapitull të këtij blloku, masat kyçe të planifikuara për periudhën raportuese të cilat *nuk kanë arritur të përmbushen brenda afatit të paraparë* janë:

- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushat e tregut të brendshëm: UA për kërkesat themelore për punët e ndërtimit, sistemin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës dhe deklaratën e performancës së produkteve të ndërtimit; dhe UA për rregullimin e çmimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale;
- Miratimi i tri akteve nënligjore në fushën e kapitalit dhe të së drejtës së kompanive: UA për pronarin përfitues; UA për pavarësinë e auditorit; dhe UA për mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë;
- Hartimi i dy akteve nënligjore në fushën e kapitalit: UA për zbatimin e Rregullores për treguesit e leverazhit; dhe UA për zbatimin e rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit;
- Miratimi i strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e autorit;
- Hartimi i raportit me gjetjet nga analiza në sektorin e telekomunikimit.
- Miratimi i koncept-dokumentit për masat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit;

- Miratimi i dy akteve nënligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural: UA për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2019; dhe UA për pagesat direkte në bujqësi për vitin 2019;
- Miratimi i projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i projektligjit të lehonisë dhe prindëror;
- Miratimi i tetë akteve nënligjore në fushën e sistemit të drejtësisë: UA për regjistrin e ndërmjetësuesve; kodit të mirësjelljes së ndërmjetësuesve; UA për tarifën, shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbartuesit privatë (plotësim-ndryshim); UA me të cilin përcaktohet procedura e vet-inicimit të rasteve dhe rastet e referimit nga organi administrativ; UA për tarifën për ndërmjetësues; UA për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve; UA për licencimin e ndërmjetësuesve; dhe UA për mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve;
- Miratimi i rregullores për Autoritetin Qeveritar për Migrim;
- Miratimi i UA për praktikën e mira për shpërndarje;
- Miratimi i projekt-kodit doganor dhe të akcizave (plotësim-ndryshim).

Në anën tjetër, masat kyçe ku ka *sfida dhe vonesa të mundshme*, dhe që, si të tilla, *kërkojnë vëmendje* në kuadër të këtij blloku janë si në vijim:

- Miratimi i projektligjit për inspektime;
- Miratimi i UA për kriteret e parapara për fitimin e të drejtës në ushtrimin e profesionit të rregulluar;
- Miratimi i Kodit për Qeverisje Korporative;
- Miratimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e bujqësisë dhe atë të sigurisë së ushqimit: projektligjit për ushqimin; projektligjit për veterinarinë; projektligjit për farëra; projektligjit për materialin fidanor; si dhe i rregullores mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e transportit: vendosja e rrjetit të internetit, pajisa me kompjuter dhe siguri i sallave të testimit për kandidatët për shoferë; dhe autorizimi i subjekteve për kontrolle mobile;
- Miratimi i ligjeve dhe politikave në fushën e ndërmarrjeve dhe të industrisë: projektligjit për inovacion dhe ndërmarrësi; dhe strategjisë për inovacion dhe ndërmarrësi;
- Miratimi i pesë akteve nënligjore dhe akteve të tjera rregullative në fushën e energjisë: UA lidhur me kërkesat për eficientësi të energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror; Rregullores për etiketat e pajisjeve që shpenzojnë energji; Rregullores për kriteret minimale për auditimet e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë; dhe Udhëzuesit për mënyrën e raportimit për raportet vjetore dhe për progresin e Planit Kombëtar të Veprimtari për Eficientësi të Energjisë;
- Themelimi i Bursës së Energjisë Kosovë – Shqipëri;
- Miratimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (plotësim-ndryshim);
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e gjyqësorit përmes trajnimeve: të paktën nga një trajnim për gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë policorë në fushën e pronësisë industriale dhe për fushën e së drejtës së autorit;
- Zbatimi i 54 vendimeve të KKPB-së (të përcaktuara për këtë vit nga 143 vendimet e skemës së kompensimit) në lidhje me skemën e kompensimit, të trashëguara nga Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore, përfshirë vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
- Nënshkrimi i tri marrëveshjeve bilaterale me Malin e Zi në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: për ekstradim; për ekzekutim të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale; dhe për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet penale;
- Miratimi i një akti nënligjor dhe dokumenteve të politikave në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: UA për Refuzimin e Hyrjes në Republikën Kosovës (plotësim-ndryshim); dhe i planeve komunale të riintegritimit;

- Miratimi i tri projektligjeve (plotësim-ndryshim) në fushën e mjedisit: për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes; për ujërat e Kosovës; dhe për gjuetinë;
- Miratimi i një akti nënligjor dhe një dokumenti politikash në fushën e mjedisit: UA për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest (plotësim-ndryshim) dhe Planit të Veprimit 2020 – 2022 për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017 – 2036;
- Përgatitja e dy raporteve mbi zbatimin e vendimit të Qeverisë për ndalim të përdorimit të thëngjillit në institucionet publike;
- Miratimi i Planit strategjik për shëndetin e nënës dhe fëmijës;
- Hartimi i doracakut për auditimet e pajtueshmërisë si dhe Rishikimi i pyetësorit vetë-vlerësues.

0.4. Gjendja sipas institucioneve


Kjo pjesë jep një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të Programit për institucionet cilat kanë planifikuar zbatim të aktiviteteve në periudhë periudhën janar – mars. Me qëllim të vlerësimit të performancës, institucionet janë *ranguar sipas përqindjes së masave të zbatuara*, nga ai me *performancën më të dobët* deri te ai me *performancën më të mirë*.

Sa i përket performancës së *institucioneve të Qeverisë* në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e tyre *gjatë tremujorit të parë*, gjetjet tregojnë si në vijim:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
2. Ministria e Drejtësisë (MD) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
3. Ministria e Financave (MF) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
4. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
6. Ministria e Shëndetësisë (MSh) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) - 0% (0/1 masë e zbatuar);
8. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) - 0% (0/1 masë e zbatuar)
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) - 42.11% (8/19 masa të zbatuara);
10. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - 50% (1/2 masa të zbatuara);
11. Ministria e Administratës Publike (MAP) - 75% (1/4 masa të zbatuara);
12. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) - 80% (8/10 masa të zbatuara); dhe
13. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) - 100% (2/2 masa të zbatuara);

Performanca e pjesës së mbetur të institucioneve të Qeverisë gjatë tremujorit të parë *nuk mund të matet*, pasi që asnjë masë nën përgjegjësinë e tyre nuk është planifikuar të zbatohet brenda kësaj periudhe.

Diagrami 0.4.1. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019 sipas institucioneve: Performanca e institucioneve të Qeverisë




Në anën tjetër, sa i përket performancës së *institucioneve të tjera* në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e tyre gjatë tremujorit të parë, gjetjet tregojnë si në vijim:

1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) – 0% (0/1 masa të zbatuara); dhe
2. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) – 0% (0/3 masa të zbatuara).

Performanca e pjesës së mbetur të institucioneve të tjera gjatë tremujorit të parë *nuk mund të matet*, pasi që asnjë masë nën përgjegjësinë e tyre nuk është planifikuar të zbatohet brenda kësaj periudhe.

Diagrami 0.4.2. Pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019 sipas institucioneve – performanca e institucioneve të tjera



1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit


1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 (20%) masë legislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

1.1.2. Administrata publike

Ky kapitull përmban 23 masa: 1 (20%) masë legislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; prej tyre, 5 masa janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë: 3 (13%) masa legislative dhe 2 (8.8%) masa zbatuese.

Diagrami 1.1.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Administrata publike



Sa i përket shkallës së zbatimit të *këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë*, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 20% e masave, 1 masë, janë zbatuar plotësisht;
- 80% e masave, 4 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi nuk përballlet me vonesa serioze dhe masat e planifikuara janë në zbatim e sipër. Një vonesë e vogël e paraqitur sipër është lidhur me miratimin e Ligjit për Racionalizim të Agjencive dhe atij për Konfliktet Administrative. Po ashtu, vonesë ka hasur edhe UA nr. 2012/01 për monitorimin e punës së organeve të komunave përmes teleprezencës dhe funksionalizimi i portalit e-Kosova. Megjithatë, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë Ligjeve të lartpërmendura gjatë tremujorit të dytë pasi që veçse janë në fazën e konsultimeve publike.

1.1.3. Avokati i Popullit

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.


1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare

Ky kapitull përmban 5 masa: 2 (40%) masa legislative dhe 3 (60%) masa zbatuese; prej tyre, 1 masë legislative (20%) është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 1.2. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare



Sa i përket shkallës së zbatimit të *këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë*, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi ka vonesa në zbatimin e masave. Vonesë është paraqitur në miratimin e Projekt Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit për Mjekësinë Ligjore cila ka qenë e paraparë të miratohet në tremujorin e parë të këtij viti. Masat tjera në këtë sektor janë duke u zbatuar sipas planifikimit.

2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 (20%) masë legislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky kapitull përmban 6 masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull përmban 11 masa: 5 (45.45%) masa legjislative dhe 6 (54.54%) masa zbatuese; prej tyre, 2 masa legjislative (18.18%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.1. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Lëvizja e lirë e mallrave



Sa i përket shkallës së zbatimit të *këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë*, gjetjet tregojnë se asnjëra nga 2 masat e planifikuara nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi është në proces të zbatimit të masave të planifikuara. Vonesat e paraqitura në UA-të sipër kanë të bëjnë me UA për Kërkesat themelore për punët e ndërtimit, sistemin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës dhe deklaratën e performancës së produkteve të ndërtimit, i cili veç se e ka kaluar procedurën e diskutimit publik si dhe UA për Rregullimin e çmimit të produkteve dhe pajisjeve medicinale, i cili është në pritje të miratimit nga Ministri i Shëndetësisë. Përveç këtyre, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë procedimit të Ligjit për Inspektime i cili është i planifikuar të miratohet në Qeveri në qershor 2019.

3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Ky kapitull përmban 4 masa: 3 (75%) masa legjislative dhe 1 (25%) masë zbatuese ndërsa asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit

Ky kapitull përmban 9 masa: 4 masa legjislative (45%) dhe 5 masa zbatuese (55%); prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik

Ky kapitull përmban 3 masa: 1 (33.33%) masë legislative dhe 2 (66.66%) masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive

Ky kapitull përmban 4 masa: 3 masa legislative (75%) dhe 1 masë zbatuese (25%); prej tyre, 2 masa legislative (50%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.6. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: E drejta e kompanive




Sa i përket shkallës së zbatimit të **këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë se asnjëra nga 2 masat e planifikuara nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi ballafaqohet me disa vonesa serioze në zbatimin e masave legislative. Përderisa UA për kërkesat, kushtet, dhe procedurat për krijim e Numrit Unik Identifikues është zbatuar para afatit të paraparë, vonesa paraqiten në hartimin dhe miratimin e UA për Pavarësinë e Auditorit dhe atij për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Cilësisë.

3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale

Ky kapitull përmban 10 masa zbatuese; prej tyre, 1 masë (10%) është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.7. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: E drejta e pronësisë intelektuale



Sa i përket shkallës së zbatimit të **këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë si 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi nuk ballafaqohet me vonesa serioze dhe shumica prej **këtij kapitulli** janë duke u zbatuar pa vonesa. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Autorit e cila duhet të zbatohet në javët në vazhdim.

3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës

Ky kapitull përmban 14 masa: 3 (21.43%) masa legislative dhe 11 (78.57%) masa zbatuese; prej tyre, 1 masë zbatuese (7.14%) është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.8. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Politikat e konkurrencës




Sa i përket shkallës së zbatimit të **këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi ka shënuar progres në zbatimin e masave. Një vonesë serioze e paraqitur sipër ka të bëjë me hartimin e Raportit me gjetjet nga analiza në sektorin e telekomunikimit. Përveç kësaj të fundit, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë procedimit të Koncept dokumenti për Ligjin për Konkurrencën si dhe Rregullores De Minimis për Ndihmë Shtetërore të cilat janë planifikuar të zbatohen në qershor 2019.

3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare

Ky kapitull përmban 11 masa: 9 (81.82%) masa legislative dhe 2 (18.18%) masa zbatuese; prej tyre, 3 masa (27.27%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë: 2 masa legislative dhe 1 masë zbatuese.

Diagrami 3.9. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Shërbimet financiare



Sa i përket statusit të ecurisë së zbatimit të **këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të parë**, gjetjet tregojnë se asnjëra nga 3 masat e planifikuara akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.


Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi ka vonesa serioze mirëpo të cilat ka indikacione që do të përfundojnë gjatë tremujorit të dytë. Vonesa serioze janë paraqitur tek miratimi i manualit për mbikëqyrjen on-site të pensioneve, përgatitjen e udhëzimit administrativ për zbatimin e Rregullores për treguesit e leverazhit dhe përgatitjen e udhëzimit administrativ për zbatimin e Rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit. Andaj, duhet t'i kushtohet rëndësi zbatimit të këtyre masave gjatë tremujorit të dytë. Përveç kësaj, rëndësi duhet t'i kushtohet edhe zbatimit të

masave me afat në qershor si hartimi dhe miratimi i manualit për menaxhimin e rrezikut dhe Rregullës 17 mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar Punëdhënës.

3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull përmban 14 masa: 8 (57%) masa legislative dhe 6 (43%) masa zbatuese; prej tyre, 1 masë zbatuese është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.10. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Shoqëria e informacionit dhe mediat




Sa i përket shkallës së zbatimit të këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi, me përjashtim të një mase, nuk përballet me vonesa serioze dhe masat e planifikuara janë në zbatim e sipër. Një vonesë serioze është paraqitur dhe ndërlikohet me miratimin e koncept-dokumentit për masat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit. Sidoqoftë, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë procedimit të hartimit të rregulloreve dhe ligjeve, si dhe masave zbatuese të cilat planifikohen të miratohen/zbatohen deri në qershor 2019.

3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ky kapitull përmban 16 masa: 10 (62.5%) masa legislative dhe 6 (37.5%) masa zbatuese; prej tyre, 10 masa legislative (62.5%) janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të parë.

Diagrami 3.11. Zbatimi i PKZMSA-së gjatë periudhës janar – mars 2019: Bujqësia dhe zhvillimi rural



Sa i përket shkallës së zbatimit të këtij kapitulli gjatë tremujorit të parë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 80% e masave, 8 masa, janë zbatuar plotësisht;
- 20% e masave, 2 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky sektor në përgjithësi nuk përballet me vonesa serioze dhe masat e planifikuara janë në zbatim e sipër. Dy vonesa të paraqitura sipër janë miratimin e UA për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi

dhe zhvillim rural dhe UA për pagesat direkte në bujqësi. Megjithatë, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë miratimit të këtyre UA dhe procedimit edhe të Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i cili planifikohet të kryhet në qershor 2019.

3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Ky kapitull përmban 10 masa: 8 (80%) masa legjislative dhe 2 (20%) masa zbatuese; prej tyre, asnjë masë nuk është planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të parë, prandaj shkalla e zbatimit të këtij kapitulli gjatë kësaj periudhe nuk mund të matet.

3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

